Marrë: Shqipërinë

Vlerësimet Komb.; Udork.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS AND DIASPORA

Njesia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 4.0
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 3462
Nr. Faqeve / Br. Stanica / No. Pages: 06
Data / Datum / Date: 08.08.2023
Prishtinë / a

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE**

**INOVACIONIT TË**

**REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**DHE**

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT TË**

**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR**

**SHKËMBIMIN E PËRVOJAVE LIDHUR ME PJESËMARRJEN NË VLERËSIMET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE TË NXËNËSVE SI DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL PËR VLERËSIMET E MËSUESVE**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë (në vijim "Palët");

Nisur nga nevoja, vlerat, interesat e përbashkët, si dhe dëshira për të realizuar bashkëpunim produktiv të ndërsjellë, për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve ndërmjet të dy vendeve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

**Neni 1**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi (në vijim MB) është bashkëpunimi institucional për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve.

### Neni 2

Institucionet përgjegjëse për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve, në vendet respektive janë ministritë përgjegjëse për arsimin, dhe institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar në varësi të tyre.

### Neni 3

1. Bashkëpunimi institucional për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare të nxënësve, si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve, në vendet respektive, do të realizohet përmes:
   a. Shkëmbimit të përvojave dhe materialeve lidhur me vlerësimet ndërkombëtare të nxënësve PISA, TIMSS, PIRLS, ICILS etj.
   b. Shkëmbimit të përvojave lidhur me sondazhin ndërkombëtar të drejtuesve dhe mësuesve të shkollave TALIS 2024.
   c. Shkëmbimit të përvojave lidhur me vlerësimet dhe provimet kombëtare që zhvillohen në vendet respektive.
   d. Hartimit të materialeve të përbashkëta për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në arsimin parauniversitar lidhur me vlerësimet/sondazhet ndërkombëtare.
   e. Bashkëpunimit institucional për zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave të arsimit parauniversitar lidhur me aftësitë që zhvillohen në vlerësime ndërkombëtare.
   f. Bashkëpunimit institucional për shkëmbimin e përvojave në drejtim të integrimit të TIK në procesin mësimor.
   g. Bashkëpunimit institucional për shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e politikave të unifikuara për zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve.
   h. Promovimit dhe nxitjes së mësuesve drejt binjakëzimeve të shkollave të përfshira ne e-Twinning.

### Neni 4

1. Bashkëpunimi i përcaktuar me këtë MB do të zbatohet në pajtim me legjislacionin në fuqi të të dy vendeve, si dhe sipas marrëveshjeve të pjesëmarrjes në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Për qëllim të zbatimit të kësaj MB do të ngrihet një Komitet i Përbashkët nga Palët, i përbërë nga 3 (tre) përfaqësues të secilës Palë. Komiteti i Përbashkët takohet dy herë brenda vitit ose kurdoherë që është e nevojshme, në mënyrë alternative në Tiranë dhe Prishtinë, me qëllim të shqyrtimit të çështjeve me interes për zbatimin e MB.

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**DHE**

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR**

**SHKËMBIMIN E PËRVOJAVE LIDHUR ME PJESËMARRJEN NË VLERËSIMET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE TË NXËNËSVE SI DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL PËR VLERËSIMET E MËSUESVE**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë (në vijim "Palët");

Nisur nga nevoja, vlerat, interesat e përbashkët, si dhe dëshira për të realizuar bashkëpunim produktiv të ndërsjellë, për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve ndërmjet të dy vendeve.

Kanë rënë dakord si më poshtë:

**Neni 1**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi (në vijim MB) është bashkëpunimi institucional për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve.

**Neni 2**

Institucionet përgjegjëse për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve, në vendet respektive janë ministritë përgjegjëse për arsimin, dhe institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar në varësi të tyre.

**Neni 3**

1. Bashkëpunimi institucional për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare të nxënësve, si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve, në vendet respektive, do të realizohet përmes:
    a. Shkëmbimit të përvojave dhe materialeve lidhur me vlerësimet ndërkombëtare të nxënësve PISA, TIMSS, PIRLS, ICILS etj.
    b. Shkëmbimit të përvojave lidhur me sondazhin ndërkombëtar të drejtuesve dhe mësuesve të shkollave TALIS 2024.
    c. Shkëmbimit të përvojave lidhur me vlerësimet dhe provimet kombëtare që zhvillohen në vendet respektive.
    d. Hartimit të materialeve të përbashkëta për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në arsimin parauniversitar lidhur me vlerësimet/sondazhet ndërkombëtare.
    e. Bashkëpunimit institucional për zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave të arsimit parauniversitar lidhur me aftësitë që zhvillohen në vlerësime ndërkombëtare.
    f. Bashkëpunimit institucional për shkëmbimin e përvojave në drejtim të integrimit të TIK në procesin mësimor.
    g. Bashkëpunimit institucional për shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e politikave të unifikuara për zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve.
    h. Promovimit dhe nxitjes së mësuesve drejt binjakëzimeve të shkollave të përfshira ne e-Twinning.

**Neni 4**

1. Bashkëpunimi i përcaktuar me këtë MB do të zbatohet në pajtim me legjislacionin në fuqi të të dy vendeve, si dhe sipas marrëveshjeve të pjesëmarrjes në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Për qëllim të zbatimit të kësaj MB do të ngrihet një Komitet i Përbashkët nga Palët, i përbërë nga 3 (tre) përfaqësues të secilës Palë. Komiteti i Përbashkët takohet dy herë brenda vitit ose kurdoherë që është e nevojshme, në mënyrë alternative në Prishtinë dhe Tiranë, më qëllim të shqyrtimit të çështjeve me interes për zbatimin e MB.

**Neni 5**

Realizimi i kësaj MB për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve do të mbulohet nga secila Palë sipas mundësive financiare.

**Neni 6**

Kjo MB lidhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe rinovohet automatikisht për të njëjtën periudhë, nëse asnjëra prej Palëve nuk e njofton Palën tjetër, me shkrim, për ndërprerjen e saj.

Secila Palë mund të njoftojë Palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e MB. Përfundimi do të ketë efekt tre muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.

**Neni 7**

Kjo MB mund të ndryshohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

**Neni 8**

Kjo MB hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj.

Nënshkruar në __________, më _____ 2023, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, ku të dy tekstet janë njëlloj autentike

| | |
|---|---|
| **PËR MINISTRINË E E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS** | **PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË** |
| **MINISTRI** | **MINISTRI** |
| **ARBËRIJE NAGAVCI** | **EVIS KUSHI** |

**Neni 5**

Realizimi i kësaj MB për shkëmbimin e përvojave lidhur me pjesëmarrjet në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe zhvillimin profesional për vlerësimet e mësuesve do të mbulohet nga secila Palë sipas mundësive financiare.

**Neni 6**

Kjo MB lidhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe rinovohet automatikisht për të njëjtën periudhë, nëse asnjëra prej Palëve nuk e njofton Palën tjetër, me shkrim, për ndërprerjen e saj.

Secila Palë mund të njoftojë Palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e MB. Përfundimi do të ketë efekt tre muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.

**Neni 7**

Kjo MB mund të ndryshohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

**Neni 8**

Kjo MB hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj.

Nënshkruar në , më .2023, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, ku të dy tekstet janë njëlloj autentike

| | |
|---|---|
| **PËR MINISTRINË E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË SË INOVACIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS** | **PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT TË REPUBLIK SË SHQIPËRISË** |
| **MINISTRI** | **MINISTRI** |
| **ARBËRIE NAGAVCI** | **EVIS KUSHI** |